



“DOKTOR GJILPËRA” FAIK KONICA

Punoi:
Mr.sc. Hatixhe Rexhepi

Faik Konica

- Faik Konica zë një vend të rëndësishëm në letërsinë tonë të Rilindjes dhe të Pavarësisë. Ai është prozator dhe poet, publicist dhe estetist, kritik letrar dhe përkthyes, ai me veprën e tij të shumanshme pasuroi dhe ngriti në lartësi të reja fjalën shqipe dhe mendimin letrar shqiptar.
- Veprimtarinë e tij publicistike e letrare F.Konica e zhvilloi kryesisht në shtyp, në revistën "Albania" ai botoi vjersha, proza poetike, skica, tregime, portrete, ese, artikuj të ndryshëm etj. Prej tyre duhen veçuar si vepra të rëndësishme proza e gjatë satirike, "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurasit", cikli i tregimeve "Kater përralla nga Zullulandi", udhëpërshkrimi "Shqipëria si m'u duk...". Ai la në dorëshkrim anglisht veprën "Shqipëria - kopshti shkëmbor i Evropës jug-lindore" dhe ese të tjera, e cila u botua pas vdekjes (1957). Ai ishte për një shoqëri shqiptare të emancipuar dhe kërkonte që Shqipëria, si pjesë e Evropës, të mendonte e të punonte në shembullin e saj.
- Krijimtaria e tij si tipari kryesor e ka frymëm satirike, fryma stigmatizuese dhe mohuese ndaj prapambetjes, injorancës, së keqes.
- Pena e talentuar e tij provoi me sukses dhe lëvroi pothuaj gjithë gjinitë dhe llojet letrare, prozën e poezinë skicën dhe skeçin, prozën poetike dhe prozën historike, tregimin dhe novelën. E frymëzuar nga historia dhe jeta shqiptare ai u përpoq të krijonte një letërsi me koncepte bashkëkohore, me vizion të ri, me shije të lartë, larg modeleve të vjetëruara.

-
- Në radhë të parë, Konica është prozator, por ai shkroi edhe poezi, sidomos në fillimet e krijimtarisë së vet.
- Prozës së shkurtër të F. Konicës i takojnë dhe disa skica letrare dhe rrëfenjëza që ai i quan përralla si "Urika", "Në dritë të hënës", "Ai që ishte gati të vdesë për Shqipërinë" etj., me tematikë atdhetare ose përrallat "E bija e mbretit dhe trëndafilat", "I urti i malit" etj., shkrime këto plot fantazi nga bota e legjendave.
- F. Konica është i pari që lëvroi në prozën tonë esenë, një lloj letrare-publicistike, me mundësi të reja shprehëse. Nëpërmjet tyre, ai parashtroi mendime origjinale, ngriti probleme të rëndësishme, të kohës, tregoi për diturinë e gjerë që zotëronte. Një nga esetë më të bukura është "Jeta dhe librat", ku, duke dhënë gjykime për vlerën e librit në jetën e njerëzimit, i bëhet një analizë ideo-artistike tragjedisë së Eskilit "Prometeu i lidhur".
- Në trajtë esesh Konica ka shkruar veprën "Shqipëria- kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore". E hartuar për lexuesin e huaj, shkrimtari i jep atij një enciklopedi të vogël për Shqipërinë dhe popullin e saj.
- Të dhjetë esetë, nga të cilat përbëhet libri përbëjnë një mozaik të historisë dhe kulturës shqiptare, të gjuhës e të letërsisë, të botës shpirtërore dhe psikologjisë së shqiptarëve. Me një informacion të gjerë dhe njohje të thellë, duke harmonizuar objektivitetin shkencor me një rrëfim të këndshëm autori nxjerr në pah individualitetin dhe natyrën e popullit shqiptar jo vetëm parë në vetvete, por edhe në kuadrin ballkanik dhe evropian.

DOKTOR GJILPËRA

- *Doktor gjilpëra* është kryevepra në prozë e Faik Konicës. Ky roman i papërfunduar u botua në disa numra të gazetës "Dielli" në Amerikë, në vitin 1924.
- Faik Konica e përdori një mjeshtëri të rrallë të përdorimit të gjuhës, e cila gjuhë është e pasur, e bukur, e fuqishme me ndërtime e struktura sintaksore thjesht shqipe, që jo secili shkrimtar mund ta bënte.
- Vlera e veprës *Dr. Gjilpëra*, pa dyshim, qëndron në idetë e mëdha ndriçuese, duke krijuar një gjendje të aktualitetit, Konica paralelisht bën thirrje për njohjen dhe hyrjen e shqiptarëve në modernitet.
- Vepra shtron problemin e intelektualit të ri shqiptar, *Doktor Gjilpëra*, që kryen studimet për mjekësi në Rusi e Suedi dhe ndodhet para alternativës: të qëndronte jashtë, ku e priste një karrierë plot prespektivë apo të kthehej në atdhe e të ndihmonte në mëkëmbjen e tij, veçanërisht në përmirësimin e shëndetit të popullit. Ai vendos të kthehet në Shqipëri, atdhedashuria triumfon mbi interesat vetjake.

-
- Autori duke ndjekur vijën e jetës së heroit do ta përshkruajë atë në dy etapat kryesore: koha e qëndrimit jashtë atdheut dhe koha e ardhjes në Shqipëri. Në qoftë se etapa e parë është njohja me doktor Gjipërën, etapa e dytë, që përbën trungun e veprës është pjesa më e rëndësishme, që bart dhe mishëron idetë e shkrimtarit. Jeta e heroit larg atdheut është dhënë në plan përshkrues, duke evokuar episode dhe gjendje të ndryshme shpirtërore, që nxjerrin në pah natyrën, interesat dhe karakterin e intelektualit shqiptar. Ai është në radhë të parë, atdhetar i bindur, njeri me kulturë të gjerë, mjek i përgatitur dhe human, i zgjuar dhe plot vullnet e vendosmëri. Janë këto cilësi, që e bëjnë atë të kthehet në atdhe.
- Ajo që do ta tronditë mjekun modern të ashtuquajtur *Doktor Gjilpëra* do të jetë kthimi i tij në Shqipëri, ku do të përballlet me probleme të ndryshme të jetës shqiptare.
- Ai brenda një kohe të shkurtër do të njihet me gjendjen e mjeruar të popullit, me padrejtësitë që bëhen në kurriz të tij, me aparatit shtetëror, ku mbizotërojnë arbitrariteti, drama, intrigat, me nëpunës injorantë e anadollakë. Në këtë shtet tragjiko-komik, opozitën e përbëjnë njerëz që s'kanë asgjë të përbashkët me ligjin dhe moralin.

- Por, ajo që e zë vendin kryesor në këtë vepër janë marrëdhëniet që vendos doktor Gjëlpëra me kategori të ndryshme të shoqërisë shqiptare, me përfaqësuesit e tyre më tipikë. Në këto raport e shohim qartë karakterin dhe botkuptimin e doktor Gjëlpërës, ideali i një njeriu europian, atdhetarizmi dhe humanizmi i një njeriu të emancipuar, ndërsa nga ana tjetër, vizatohen figura të ndryshme të qarqeve zyrtare të parisë të rretheve intelektuale.
- Veçanërisht figura e doktor Gjilpërës del mjaft e qartë përballë dy kolegëve të tij, dr.Embrullahut dhe dr.Protogor Dhallës. Më shumë, se në rethana pune, ata i njohim në biseda e debate, si tipa shoqërorë të kundërt me heroin, me koncepte dhe praktika të ndryshme mjekësore. Ndërsa doktor Gjëlpëra është njeriu i mjekësisë moderne, partizan i natyrës, i helioterapisë (dielli, uji, ajri) që mendon se natyra është mjeku i parë i njeriut, dy mjekët e tjerë paraqiten anakronikë, janë mishërim i dogmës mjeksore të shkëputur nga jeta e parimet e shkencës. Bota e vjetër në këtë vepër përbëhet jo vetëm nga dy mjekë, por dhe nga figura të tjera negative. I tillë është ministri Salemboza, përfaqësues tipik i forcave të prapambetura e antikombëtare, tipi i tiranit anadollak, intrigant e dinak, i zgjuar e i shkathët. Kurse mjedisi dhe mendësia orientale e parisë së kryeqytetit gjejnë shprehjen e tyre në figurat e agallarëve tiranas siç janë Muhedin Agai e Zylfikar Agai.
- Autori ndesh edhe njerëz të mirë në popullsin shqiptare, që ngjallin simpati e nderim. Mbeten të paharruara në mendjet e lexuesit dy vajzat fshatare, plaku martaneshas, polici i doganës, Arifeja, Ali Bibi.

-
- Është e pamundur që lexuesi gjatë leximit të kësaj vepre mos ti vi për të qeshur. Prandaj, me gojën plot e them se: "Doktor Gjëlper" është një vepër e fuqishme satitike.
- Duke pasur parasysh realitetin e rëndë shqiptar, mendimet anakronike e jetën e prapambetur, autori u kundërvihet atyre, i tall dhe i godet pa mëshirë. Qëndrimi ideoemocional mohues bën që në faqet e veprës të ndihet qesëndia dhe ironia, satira dhe sarkazma. Ata shfaqen e mishërohen me forcë artistike në skena dhe personazhe, në situata dhe portrete tepër të goditura.

-
- Tema dhe problematika e mprehtë shoqërore, fryma mohuese e disa prej dukurive shoqërore dhe notat e fuqishme satirike e bëjnë "Doktor Gjëlpërën" një vepër me tipare të shquara realiste. Konica sjell kështu një ndihmesë të rëndësishme në pasurimin dhe forcimin e realizmit në letërsinë shqiptare. Nga pikpamja kompozicionale, edhe pse vepra është e papërfunduar, janë hedhur linjat kryesore dhe është përcaktuar edhe thelbi i figurës së heroit. Mund të themi se ajo përbën hyrjen e një romani që Konica për arsye të ndryshme nuk e çoi deri në fund.
- Vepra është e pasur me lëndë jetësore, e ngarkuar me ngjarje e biseda, me detaje të shumta. Këto kanë sjellë ngathësimin e aksioneve dhe njëfarë proleksiteti.

- F.Konica është një nga stilistët e rrallë të gjuhës shqipe. Ai zbatoi parimin se ekonomizimit të fjalës, të lakonizimit të saj, duke synuar hijeshinë, saktësinë, thjeshtësinë dhe elegancën. Ndikimi i personalitetit të Konicës si artist dhe si zotërues i njohurive dhe dijeve të thella është i ndjeshëm në kulturën dhe letërsinë shqiptare.

Përfundim

- **Proza e Faik Konicës** është e shkruara me një gjuhë të bukur e ndjenjë të hollë, me mbresa e detaje të goditura, këto proza mbeten shembuj, në llojin e tyre në letërsinë tonë. Të përafërta me prozat poetike qëndrojnë portretet letrare që krijoi Konica mbi disa figura të shquara të historisë shqiptare si: Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Jeronim De Rada, Ali Pashë Tepelena, At Shtjefën Gjeçovi etj. Ato dallohen për aftësinë e autorit në përvijimin e saktë dhe të hijshëm të karakterit të tyre, portretit shpirtëror e fizik të dhënë qartë dhe në mënyrë lakonike.
- Faik Konica kishte kërkesa të larta ndaj letërsisë dhe shkrimtarëve. Duke i vështuar në raporte të drejta përmbajtjen dhe formën, si dy komponentë që s'mund të ndahen nga njëri-tjetri, ai i jepte përparësi formës si e vetmja mënyrë për të shprehur sa më mirë përmbajtjen. Në këtë vështrim i kushtonte rëndësi të madhe gjuhës shqipe, pasurimit dhe përpunimit të saj. Ai vetë dha shembullin e një mjeshtri të vërtetë të gjuhës. Me të drejtë Noli e quan atë "kryelëronjësi i gjuhës sonë" dhe "stilist i përkryer".
- Proza e tij shpesh është ritmike, dhe ky ritëm ndërron bashkë me kuptimin, duke shkruar nga flajët në frazat e gjata, e anasjelltas. Meqenëse në vepër veprojnë dy botë të kundërta, dy ide të papajtueshme, figurë kryesore e tekstit është figura e kontrastit.
- Padyshim proza e Konicës zë vend të rëndësishme në prozën shqiptare.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Konica, Faik, Vepra 1, shtëpia botuese, Rilindja, Prishtinë, 1997.
- Konica, Faik, Vepra 1, shtëpia botuese, Dudaj, Tiranë, 2001.
- Matoshi, Hysen, INSTITUTI ALBANOLOGJIK, STILET NË LETËRSINË SHQIPE NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE, Prishtinë, 2008.